

**Fjala e z. Erion Veliaj,
Ministër i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë**

Shumë Faleminderit për mikpritjen e ngrohtë dhe atmosferën e shkëlqyer në këtë Kongres.

Falënderoj së pari Presidentin e KSSH z. Kol Nikollaj për këtë organizim dhe për një dëshmi të demokracisë së gjalle brenda KSSH-së.

Faleminderit edhe kolegeve të tjerë, shumë prej tyre miq nga shoqëria civile nga protestat qytetare, etj.

Me vjen mirë dhe pse kemi një qeveri me të përgjegjshme kjo nuk do të thotë të kemi me pak aksion nga shoqëria civile, e kryesisht në sindikatat që përfaqësojnë interesat më sublimë të punëtorëve të Shqipërisë.

Dua t'ju uroj mirëseardhjen në Shqipëri atyre që përfaqësojnë Konfederatat, sindikatat në vendet fqinjë, në vendet mike. Nuk kemi nevojë të bëjmë shpikje, ka shumë taktika, ka shumë teknika, organizime, mënyrë se si forcohen e fuqizohen sindikatat që të tjerët i kanë bërë përpara nesh. Prandaj më vjen mirë që kjo është një dëshmi e bashkëpunimit me KSSH po sigurisht edhe një hapësirë e shkëlqyer për të shkëmbyer informacion për të shkëmbyer taktika, për të shkëmbyer ide që funksionojnë dhe kanë pasur sukses edhe në vendet tona mike.

Prania e përfaqësuesve të koalicionit qeverisës nga LSI, nga Ministria e Arsimit, etj është një dëshmi e bashkëpunimit dhe partneritetit.

Doja të sillja përshëndetjen e Kryeministrit të Shqipërisë Edi Rama si dhe të paraqes një kontekst për situatën ku gjendemi sot në Shqipëri. Jemi në një situatë absurde, nuk kemi një opozitë prezente në Parlament dhe ku e vetmja opozitë reale që ne kemi për të diskutuar çështje shumë të rëndësishme siç ka qenë reforma e pensioneve, reforma për pensionet e minatorëve, reforma në arsimin profesional, heqja e fashos për energjinë dhe kompensimi për shtresat në nevojë, e vetmja oponencë serioze e vërtetë që ne kemi pasur me të cilën ne kemi negociuar për këto reforma të rëndësishme në Shqipëri ka qenë lëvizja sindikaliste. Më vjen mirë që kjo është një hapësirë ku qeveria nuk vjen që të dekorohet sepse nuk është roli i sindikatës të dekorojë qeverinë, po qeveria vjen këtu që të kundërshtohet që të ballafaqohet dhe të gjithë së bashku brenda një logjike të arsyeshme të gjejmë mënyra se si ne do të avancojmë kauzat tona të përbashkëta ndaj dhe më vjen mirë që në disa prej këtyre heshtjeve kemi pasur një sukses që edhe organizatat ndërkombëtare e kanë vlerësuar si fryt i bashkëpunimit me sindikatat.

Dua të ju kujtoj reformën e pensioneve, ka qenë një reformë e cila edhe për çështjen e moshës është negociuar në një mënyrë ideale falë debatit që kemi patur në KKP me KSSH. Më vjen mirë që gjithashtu dhe formula për këtë qëllim u bë e mundur falë dhe kontributit të ekspertëve të lëvizjes sindikaliste dhe KSSH. Më vjen mirë që disa arritje konkrete nga Këshilli Kombëtar i Punës dhe bashkëpunimi tripartitist mes sindikatave, mes punëdhënësve dhe qeverisë ka prodhuar rezultate të shkëlqyera. Vetëm në vitin e fundit ekonomia jonë gjeneroi 81352 vende pune, vende të zyrtarizuara në pagesat e sigurimeve shoqërore. Rreth 1/3 janë vende të reja pune, rreth 1/3 janë vende të zbardhura nga puna e zezë falë kontributit të sindikatave që kanë denoncuar punën në të zezë, dhe 1/3 janë të vetëpunësuarit në fshat që kanë përfutur nga amnistia dhe janë duke u vetëdeklaruar dhe që nesër të kenë një pension dinjitoz. Për të vazhduar me këtë ritëm të vendeve të punës edhe në vitet e ardhshme na duhet ndihma e sindikatave. Ju bej thirrje të gjithëve që përfaqësoni sindikatat individëve, degëve të KSSH nëpër rrethe të denonconi aty ku punohet në të zezë që inspektorët e ISHPSHSH të ketë mundësi të zbardhin cdo vend pune jo për të mbushur arkën e shtetit por kundër asaj që quhet skllavëri moderne, duhet të punojë në të zezë, të mos paguaj sigurime shoqërore dhe kështu jetën në moshën e tretë pa një pension dinjitoz. Për këtë kam shumë besim që sindikatat do të vazhdojnë të denoncojnë çdo sipërmarrje e cila tekta ndihmohet nga fondet e nxitjes së punësimit duhet që asnjë punonjës të mos vazhdojë të punojë në të zezë. Kjo është diçka që kërkoj nga ju dhe të vazhdojmë të bashkëpunojmë për të denoncuar të gjithë ata që vazhdojnë të punojnë në të zezë.

Dua gjithashtu të ju falënderoj për një reformë tjetër shumë të rëndësishme që është reforma në arsimin profesional. Për herë të parë ne kemi kaluar nga një administrim centralist, nga një administrim qendror i shkollave profesionale në një sistem të decentralizuar të arsimit profesional ku shkollat profesionale në të ardhmen po drejtohen në bashkëpunim me biznesin dhe sindikatat, KSSH-në. Së pari këtë e bëjmë se duam një model të modernizuar, një model që është shumë i ngjashëm me modelin gjerman, austriak dhe zviceran ku nxënësit kalojnë po aq kohë në vendin e punës aq sa kalojnë kohë edhe në shkollë. Ne duam që duke i pasur sindikatat ashtu siç kemi biznesin të përfaqësuar në këshillat drejtuese në bordet e shkollave profesionale të arrijmë tu mësojmë nxënësit që përpara se të futen në tregun e punës të marrin njohuri për të drejtat e tyre të punës, për të drejtën sindikale, të drejtën për protesta, të drejtën për të pasur sigurime shoqërore e shëndetësore, të drejtën për të deklaruar të plotë pagën e tyre dhe vitet e punës, për të drejtat që kanë për sigurinë dhe shëndetin në punë. Ndaj është shumë e rëndësishme që ky model i ri në bashkëpunim me sindikatat dhe komunitetin e biznesit të funksionojë në mënyrë të përsosur në mënyrë që brezi i ri i punëtorëve, brezi i ri i sindikalisteve janë më të arsimuar janë më dinjitoz dhe futen në tregun e punës shumë të qartë për gjithë të drejtat dhe detyrimet që kanë. Dua të falënderoj Presidentin e KSSH dhe gjithë ekipin e tij për punën e shkëlqyer që ne kemi pasur për reformën e pensioneve të minatorëve. Falë kësaj reforme për 3840 minatorë arritëm

të ulim me 5 vjet moshën e daljes në pension, pasi ishte e padrejte që politikanët të dilnin në pension më shpejtë se minatorët, një padrejtësi që siç u premtua nga koalicioni ynë PS-LSI u mbajt brenda vitit tonë të parë të qeverisjes. Kur ne punojmë për gjera që realisht kanë interes publik, interesin e punëtorëve me sa duket ka më shumë gjera që na bashkojnë se sa na ndajnë dhe do të doja ti bëja thirrje jo vetëm sindikalistëve këtu në sallë por kujtdo tjetër pavarësisht nga bindjet e tyre politike të bashkëpunojmë edhe për çështje të tjera të rëndësishme siç është paga minimale. Ne jemi shumë të vendosur që vitin tjetër ta rrisim pagën minimale pasi kjo çon në rritjen e nivelit të jetesës sidomos të atyre punëtorëve që janë në nivelin e pagës minimale. Do të doja ti bëja një thirrje edhe komunitetit të biznesit për të kuptuar që Shqipëria është kompetitive falë edhe rrogave të ulëta por sigurisht që Shqipëria ka nevojë edhe për mirëqënje dhe ashtu siç kemi patur favorizime të biznesit për një vit për të fuqizuar atë, për të rritur punësimin, etj. është radha që në vitin 2015 të rritim pagën minimale që punëtorët në këtë nivel të kenë mirëqënje më të mirë, dhe do të kërkoja edhe ndihmën e sindikatave për këtë aksion që duam të ndërmarrim vitin tjetër.

Përfaqësuesja e Konfederatës Ndërkombëtare të Sindikatave e përmendi se çështja e energjisë elektrike është shumë e rëndësishme dhe nuk do të ishte e mundur një reformë në se nuk do të kishim negociuar me sindikatat për rimbursimin e rreth 204 mijë familjeve që do të përfitojnë nga reforma e energjisë. Çdo pensionistë, invalid, familje në ndihmë ekonomike do të marrin pagesën mujorë gjithë efektin financiar të heqjes së fashos për energjinë elektrike. Edhe nëse këto familje do të shpenzojnë më pak rimbursimin do ta përfitojnë për familjet e tyre.

Falënderojmë sindikatën e cila insistoi që askush të mos preket nga kjo reformë. Reforma e ndërmarrë ka rritur ndjeshëm arkëtimet kryesisht nga biznesi privat. 98 % e pensionistëve paguajnë të plotë energjinë elektrike dhe meritojnë respektin tonë. 93 % e invalidëve të punës e paguajnë energjinë të plotë. E si ka mundësi që biznesi nuk e paguan, prandaj duhet të sigurohemi që energjinë ta paguajnë të gjithë.

Ju uroj punime të shkëlqyera, qofshi gjithmonë me këtë frymë demokratike, ku jepni shembull dhe shumë partive politike se çfarë do të thotë demokraci e brendshme dhe lëvizjes sindikaliste, suksese dhe faleminderit.